



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

## V E N D I M

**Nr. 127, datë 28.09.2020**

### **“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E LISTAVE TË PËRFITUESVE NGA GRANTI I RIKONSTRUKSIONIT DHE PROGRAMI I RINDËRTIMIT”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenet 112-113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

## V E N D O S I :

Në vendimet e listave të përfituesve nga granti i rikonstruksionit dhe programi i rindërtimit bëhen këto ndryshime:

**1.** Në vendimin nr. 73 datë 19.06.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listës së përfituesve nga granti i rikonstruksionit”, bëhet ndreqja e gabimit material si më poshtë:

**a.** Për përfituesin Mirlind Bollati, Njësia Administrative nr. 2, Shkalla “DS1” e dëmit, zëvendësohet me nivelin “DS3”.

**2.** Në vendimin nr. 82, datë 27.07.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit”, bëhen këto ndryshime:

**a.** z. Ilir Aga me nr. rendor 101, Njësia Administrative Vaqarr, i përcaktuar në aneksin nr. 1 të pikës 2, të vendimit, hiqet nga lista e subjekteve përfituese, të programit të rindërtimit nëpërmjet ndërtimit të banesave të reja.

**b.** Për subjektin Mimoza Biba, me nr. rendor 81, Njësia Administrative “Zall Her”, zëvendësohet me Njësinë Administrative “Dajt”.

**3.** Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

**4.**Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R I**

**TONI GOGU**